VENDIM
Nr.246, datë 18.3.2004

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR SHTYPSHKRIMIN E CERTIFIKATAVE TË GJENDJES CIVILE, ME ELEMENTE SIGURIE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit që, për fondin e vet prej 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me shoqërinë "Edlor" sh.p.k. për shtypshkrimin e certifikatave të gjendjes civile, me elemente sigurie.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano